



## Federata Aeronautike e Kosovës

Në pajtim me statutin e Federatës së Aeronautike të Kosovës, bordi i Federatës Aeronautike të Kosovës në mbledhjen së vet të datës 17.05.2017 nxorri këto vendime:

### VENDIMET 4-2017

#### Vendimi 4.1

#### Miratimi i buxhetit të FAK për vitin 2017

Kryesia e FAK bëri planifikimin buxhetor për vitin 2017 dhe të njëjtën e aprovoi. Linjat e trasha buxhetore për vitin 2017 janë si në vijim:

#### Mjete në dispozicion të FAK

Memorandumi i bashkëpunimit me MKRS 2017: .....	45000.00
NLB gjendja aktuale në bankë: .....	2000.00
Te hyra te parapara nga shkolla aeronautike 2017: .....	900.00
<b>Total: .....</b>	<b>47900.00</b>

#### Borxhi aktual i FAK

Borxhet ndaj anëtarëve të kryesisë: .....	10000.00
<b>Total: .....</b>	<b>10000.00</b>

#### Investimet kapitale dhe shpezimet e planifikuara 2017

Blerja e një mjeti transportues për FAK: .....	14000.00
Pjesëmarrja në konferencën vjetore të FAI 2017: .....	2000.00
Renovimi i zyres te FAK: .....	1000.00
Auditimi financiar I FAK për 2017: .....	500.00
KOK - pagesa e anëtarësisë 2017: .....	300.00
Pagesa për anëtarët e kryesise për 6 mbledhje: .....	2400.00
Paga e kryetarit/Sekretarit: .....	3600.00
Pjesëmarrja në Oludeniz Air Games: .....	4500.00
Organizimi i dy garave ne kuader te kampionatit kombetar: .....	2000.00
Gara nderkombetare Vrsac - FAI Class 2: .....	1500.00
Gara nderkombetare Vlorë - FAI Class 1: .....	2000.00
Gara nderkombetare Slloveni - FAI Class 2: .....	3500.00
Gara nderkombetare Zvicër - FAI Class 2: .....	5000.00
Ceremonia/Kokteji i mbylljes se vitit 2017: .....	500.00
<b>Total: .....</b>	<b>42800.00</b>

Valuta: EUR

**Borxhi i paraparë i FAK në fund të vitit: 4900 EUR**



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

### **Vendimi 4.2**

#### **Shpallja e klubeve aktive për vitin 2017**

Statusi i klubeve dhe pilotëve aktiv u shqyrtua duke u bazuar në kryerjen e obligimive të tyre brenda afatit për pagesën e kuotizimit ndaj FAK si dhe ndaj përbushjes së kriterit minimal të përcaktuar nga kryesia e FAK për të qenë klub aktiv: të paturit të paktën 2 pilot të licensuar me licensa vendore si anëtarë të klubit. Sipas këtyre kriterëve klubet aktive për këtë vit janë:

- Aeroklubi Ferizaji
- Aeroklubi Fly Dardania
- Aeroklubi Gjakova
- Aeroklubi Llapi
- Aeroklubi Peja
- Aeroklubi Prishtina
- Aeroklubi Shkaba
- Aeroklubi Shqiponjat e arta

### **Vendimi 4.3**

#### **Afati i fundit për pagesë të kuotizimit**

Klubeve dhe pilotëve të cilët nuk i kanë kryer obligimet ndaj FAK, kryesia vendosi që t'ju jap edhe një afat kohor prej 1 jave (nga data e publikimi të këtij vendimi) për të kryer obligimet e tyre ndaj FAK, por në këtë rast ata duhen paguar edhe penalltinë e vonësës prej 100% të vlerës së obligimit ndaj FAK. Kështu afati për të kryer këto obligime është 31.05.2017, klubet dhe pilotët që nuk i kryejnë këto obligime do të konsiderohen klube/pilot joaktiv, dhe kryesia nuk do të ketë të drejtën e riqyrtimit të këtij statusi deri në vitin 2018!

### **Vendimi 4.4**

#### **Mbajtja e kuvendit të rregullt të FAK**

Kryesia nxorri vendim që gjatë muajit qershor të këtij viti të organizoj kuvendin e rregullt të FAK ku do të shqyrtohen ndryshimet statutores me qëllim të plotësimit të statutit të FAK si dhe harmonizimit të plotë me statutet e FAI dhe KOK.

### **Vendimi 4.5**

#### **Renovimi i zyrave të FAK**

Kryesia nxorri vendim që të përkrahet projekti i dy federatave të tjera me të cilat FAK i ndanë zyrat e saja në pallatin e federatave, Rr. Agim Ramadani pn, 10000 Prishtinë. Projekti ka të bëjë me renovimin e plotë të zyrës së përbashkët të tre federatave.



## **Federata Aeronautike e Kosovës**

### **Vendimi 4.6**

#### **Miratimi i dy rregulloreve për FAK**

Kryesia e FAK në këtë mbledhje miratoi dy rregullore të reja:

- RREGULLORE 02/2017 - RREGULLORE E PROTOKOLIT TË KOMUNIKIMIT TË FAK
- RREGULLORE 03/2017 - RREGJISTRIMI I REKORDEVE NË FLUTURIM TË LIRË ME PARAGLLAJD DHE DELTAPLAN

Të dy këto rregullore janë publikuar në webfaqen e FAK.

Prishtinë, 17.05.2017

---

Shkelqim Krasniqi  
Kryetar i bordit të FAK